

VENDIM
Nr. 160, datë 17.6.2022

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “PPC ALBANIA” SHA PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NR. 373, SERIA T17, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, 13, si dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 925/2, datë 14.6.2022, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë ‘PPC Albania’ sh.a. për rinovimin e licencës, me nr. 373, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 4.7.2017”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 19.5.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 373, seria T17, të shoqërisë “PPC Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/20 prot., datë 20.5.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 2.6.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 478/1 prot., datë 1.6.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.

- Shoqëria “PPC Albania” sh.p.k. nuk ka përcjellë asnjë përgjigje/shkresë në ERE përkundrejt shkresës nr. 478/1 prot., datë 1.6.2022.

- Në zbatim të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “e”.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germa “d”.
- Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, germa “c”.

Dokumentacioni i konstatuar në mungesë, është:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Mungon vërtetimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për administratorin e shoqërisë.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore). Konstatohet se shoqëria nuk ka depozituar vërtetimin përkatës për shlyerjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- germa “b” (paraqitje bilanci financiar të tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit)). Nuk janë depozituar në ERE pasqyrat financiare të tri viteve të fundit ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë.

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Sikurse cituar edhe në fillimin e procedurës, shoqëria ka paraqitur një analizë financiare për 4 vjet të veprimtarisë, për kostot e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike, por të pa shoqëruar me dokumentacionin financiar mbështetës për vlerat e parashikuara në këtë analizë financiare. Aktualisht shoqëria nuk ka depozituar dokumentacionin financiar mbështetës për veprimtarinë për të cilën kërkon të licencohet.

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8:

- germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh/sipas viteve). Shoqëria ka paraqitur në formë tabelare sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë për 4 vite, ndërkohë që licenca për tregtimin e energjisë elektrike ka një afat 5-vjeçar.

- germa “b” (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Sikurse cituar edhe në nenin 9, pika 3, germa “c”, shoqëria nuk ka depozituar sa kërkon kjo pikë e rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “PPC Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 373, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 93, datë 4.7.2017.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti